

Data 06.08.2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Permiresimi i aksesit nepermjet nderhyrjeve ne rruget e bardha, etj Faza III, Qarku (Shkoder, Kukes, Lezhe,Durres Tirane, Diber).”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 1,250,000,000 Lekë, pa TVSH. Sipas kursit te kembimit zyrtar te Bankes se Shqiperise vlera ne **Euro** 13,363,267.05

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar **duhet të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës së përlogaritur të marrëveshjes kuadër** në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/a e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2023, 2024, 2025** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika "b", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisë ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i

aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii.ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anetari i cili ka përqidjen me te madhe te pjesëmarrjes ne bashkim. Anetaret e tjere te bashkimit do te paraqesin kontratat e ngjashme ne raport me përqidjen e pjesëmarrjes se tyre ne bashkim.

Per te vertetuar pervojën e meparshme te ngjashme, operatorët ekonomike duhet te paraqesin deshmitë e meposhtme:

Ne rastin e pervojës se meparshme te realizuar me sektorin publik, duhet te paraqiten vertetime te leshuara nga nje ent publik, per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates dhe natyra e punes se bere.

Shënim: OE/BOE, për punët e ngjashme të realizuara që shtrihen pjesërisht brenda periudhës 5 (pesë) vjeçare, duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës provues që vërteton qartë pjesën e punimeve të realizuara brenda kësaj periudhe, si dhe vlerën monetare të punimeve të ekzekutuara gjatë saj.

Ne rastin e pervojës se meparshme te realizuar ne sektorin privat, duhet te paraqiten vertetime, per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates dhe natyra e punes se bere, e shoqeruar me:

- Kontraten/at e Siper marrjes
- Fature tatimore te situacionit perfunditar te deklaruar ne organet tatimore
- Situacioni perfundimtar

- Akt kolaudimi

Shënim: OE/BOE, për punët e ngjashme të realizuara që shtrihen pjesërisht brenda periudhës 5 (pesë) vjeçare, duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës provues që vërteton qartë pjesën e punimeve të realizuara brenda kësaj periudhe, si dhe vlerën monetare të punimeve të ekzekutuara gjatë saj.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është percaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të percaktuara në nenin e sipërcituar. Percaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar. Vlera për punë të ngjashme përben një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zoterojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të pershtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se "Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas percaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-se, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të percaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet paleve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale - të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, leshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve. Licenca duhet të përmbajë kategoritë e punimeve të kontratës si më poshtë:

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

NP 1	E	Punime gjërmimi në tokë.
NP 4	E	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
NP-5	D	Punime nëntokësore, ura e vepra arti.
NP-7	B	Ujësjellës, Gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje
NP 12	E	Punime të inxhinierisë së mjedisit.

PER PUNIMET SPECIALE TE NDERTIMIT

NS 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve
NS-4	A	Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
NS-6	A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese
NS-7	C	Barriera dhe mbrojtje rrugore
NS-9	A	Punime strukturore speciale

NS 18 A Punime topogjeodezike
NS-20 A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të leshuara nga vendi i origjines, prane Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategori a e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohet në kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1 E	Punime gërmimi në tokë	- Gërmim dheu me eskavator me goma 0.25 m³ në kanale me gjerësi deri 2m toke e zakonshme kategori III me shk në mjet (kasonete, trup ruge, veprat evogla te artit, në themele, kanale , kunete) - Gërmim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m³, në kanale gjerësi > 2 m, prani uji ~1m, kategoria III, me shk në mjet - Gërmim shkëmbi i coptuar me ekskavator 1.0 m³, shkëmb, në themele gjerësi >2 m,	201-400 mln leke	322,920,451.95 leke

		me - shkarkim ne mjet" - Germim shkambi mesatar me çekik me ekskavator me zinxhir - Germim shkambi i forte me çekik me ekskavator me zinxhir - Germim shkemb sek i lire, me mina te vogla,me ekskavator 1 m3 + transport - Rrafshim skarpate ne germim		
NP-4 E	Rruges, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale	- Mbushje me material te germuar ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges, perhapur e ngjeshur me makineri - Gjeotekstil me gramature 180 g/m2 - Gjeotekstil me gramature 280 g/m2 - Nderim drenazhi,mbushje me zhavor prodhuar mak - Mbushje me gur kave - Mbushje me shkemb te germuar me pare - Cilindrim kasonete me rul - Shtrese çekelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur makineri - Shtrese cakulli t =10/15cm makadam perhapur dhe ngjeshur me makineri - Shtrese stabilizant t=10cm - Shtrese zhavori lumi t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri - Shtrese asfaltbetoni me zall lavatrice, 3cm, me makineri - Shtrese asfaltbetoni me zall lavatrice,4cm,me mak	201 - 400 mln leke	311,077,163.87 Leke

		- Shtrese binderi me zall lavatrice, 5cm, me makineri - Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri - Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka - Shtrese rere, (Mbushje me material të shkrifet), në trotuare - F V bordura betoni 15x25 cm		
NP-5 D	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	- Struktura monolite betoni me çakell C 30/37 (per mure, soleta, etj.) (per mure, soleta ne ura b/arme) - Struktura monolite betoni C 25/30 (per mure b/arme) - Struktura monolite betoni C 20/25(per kuneta, bordura, kanale, mure pritese dhe mbajttese, portale etj.) - Struktura monolite betoni C 16/20 (themele, mure rrethues) - Struktura monolite betoni C 12/15 - F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm - F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm - Mur guri mbajtes e themele , llac cemento M 500 - Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m - Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	101-200 mln leke	197,392,314.56 Leke

NP-7 B	Ujësjiellës, Gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje	- Tuba drenimi PVC D=100 mm - Tombino me tuba betoni Ø 400, mbi shtrese betoni - Tombino me tuba betoni Ø 500, mbi shtrese betoni - Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni - Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni - Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni - Tombino me tuba betoni Ø 1500, mbi shtrese betoni - F.V. tuba tubo plastmasi d=200 mm (KUB) - F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm - F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm - Shtrese rere - F V tub drenazhi me vrima Ø 315 mm - F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 50 (per drenazhimin e mbrojtjes me beton te sprucuar)	21-50 mln leke	20,028,620.21 leke
NP-12 E	Punime të inxhinierisë se mjedisit	- Prekje bime te vogla ø-10cm - Transport dheu me auto deri 5.0 km - Mbrojtja e skarpatave me rrjete teli, nga renja e gureve - Mbrojtja e shpateve nga renja e gureve me gjeomat , i perbere nga nje polimer tredimensional dhe rrjete teli me hapje heksagonale 6x8 cm i veshur me galfan Zn-5%Al - Mbrojtja e shpateve nga renja e gureve me rrjete teli orjentim ne nje drejtim, me hapje	201-400 mln leke	276,742,153.38 leke

		hekzagonale 8x10 te perforcuar ne drejtimin 300gjatesor me kavo celiku anesore. - Mbrojtja e shpateve nga renia e gureve me rrjete teli orjentim ne nje drejtim 150 me hapje hekzagonale 8x10 te perforcuar ne drejtimin gjatesor me kavo celiku anesore dhe ne mes. - Mbrojtja e shpateve nga renia e gureve me rrjete teli (HR 30) ose e ngjashme me rezistence te larte me hapje hekzagonale 8x10 te perforcuar ne drejtimin gjatesor me kavo celiku cdo 30 cm - Mbrojtja e shpateve nga renia e gureve me rrjete teli hekzagonal 6x8 dhe diameter 2.2-2.4 mm te veshur me galfan (Zn-5%Al) me bordature anesore Ø 3.4/3.0 mm. - Torkretim me llac cemento 1: 2, t = 5 cm - Torkretim me llac cemento 1: 2, t = 3 cm - Torkretim me llac cemento 1:2, t = 15 cm - Ankera ø ne tunele, periodik (Ankera veteshpuese me diameter dhe gjatesi te ndryshme). - Hekur beton periodik, ne tunele me $S > 30 \text{ m}^2$ (Zgare metalike e elektrosalduar) - F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 50 (per drenazhimin e mbrojtjes me beton te sprucuar) - F.V. Dhe' vegjetal per mbushje (brezat e gjelber) - F.V. Fidane Peme d>10cm (peme te zones, per stabilizimin e skarpatave)		
NS-1 A	Punime per prishjen e ndërtimeve	- Prishje struktura prej guri - Prishje struktura prej betoni	0-20 mln leke	952,085.94 leke

NS-4 A	Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese	- H / Izolim me emulsion, 2 duar bitum	0-20 mln leke	463,993.27 leke
N.S-6 A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese	Tabele katrore e vogël me A=40 - Tabele katrore normal me A=60 - Tabele drejtkëndore (tregimi)(AxB) e zvogëluar 40x60 - Tabele drejtkëndore (tregimi)(AxB) e vogël 60x90 - Parapet i njeanshem per beton (ø 60) + aksesoret - " Vijezim shirita gjatesor dhe anesor me gjeresi 12 cm, Termoplastike (sprajt)" - Vijezimet e kalimit te kembesoreve. Bikomponente (paste)	0-20 mln leke	2,925,951.86 leke
N.S-7 C	Barriera dhe mbrojtje rrugore	- Guardrail H2 anesore me 3 valez. ne 1 ane ,W4 + aksesoret - Guardrail- N2 anesore me 2 valez. ne 1 ane , W3 + aksesoret - Fundore guardrail me 2 valez.	51-100 mln leke	68,344,630.60 leke

N.S-9 A	Punime strukturore speciale	- F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10mm - F V hekur betoni i zakonshem Ø > 12mm - Struktura monolite betoni me çakell C 30/37 (per pilota, traun lidhes, mure b/arme etj.) - Struktura monolite betoni C 25/30	0-20 mln leke	6,947,634.73 leke
N.S-18 A	Punime topogjeodezike.	- Rilevim Topografik, piketime ne referim te raportit dhe specifikimeve teknike	0-20 mln leke	0.00 leke
N.S-20 A	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë	- Shpim me sonda "UKS" Ø 0.6m, ~ 25m. - Shpim me sonde Ø 0.8 m, ~ 15 m, (perde mbajtese). - Shpim me sonda "UKS" Ø 0.8m, ~ 25m. - Shpim me sonda ne toka te zakonshme Ø800mm, thellesia (0-10m). - Shpim me sonda ne toka te zakonshme Ø800mm, thellesia (10-20m). - Shpim me sonda "UKS" Ø 1m,~20m,toke shkembor	0-20 mln leke	4,704,999.63 leke

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- 3 (tre) Inxhinier Ndërtimi
- 3 (tre) Inxhinier Hidroteknik
- 3 (tre) Inxhinier Gjeodet

- 3 (tre) Inxhinier Mjedisi
- 3 (tre) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Gjeolog

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

Per përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomike duhet të vetedeklarojnë disponimin e personelit kryesor në Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorezimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me një të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomike të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtesisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe vëllimet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislati për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi do të rezultojë në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me çrëftësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga përkrahja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të siguruar një rezultat sa më të mirë në mbarevajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomike duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin e objektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

Inxhinier Ndërtimi	Inxhinieri i ndërtimit nevojitet për organizimin e kantierit të ndërtimit, për ndjekjen në tërësi të punimeve dhe bën koordinim të gjithë personelit teknik në objekt për mbarevajtjen e punimeve sipas projektit të zbatimit dhe grafikut të parashikuar në kontratë. (Referuar zërave të punimeve të preventivit)
Inxhinier Hidroteknik	Inxhinieri hidroteknik nevojitet për ndjekjen e punimeve të kullimit të ujërave, tobinave; (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Mekanik	Inxhinieri mekanik nevojitet për ndjekjen e punimeve të sinjalistikës dhe barrierave metalike anësore (Referuar zërave të punimeve të preventivit).

Inxhinier Gjeodet	Inxhinieri gjeodet nevojitet për piketimin fillestar të objektit dhe piketimin në vazhdimësi të të gjithë punimeve sipas proceseve të punës. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Mjedisi	Inxhinieri i mjedisit nevojitet për ndjekjen e punimeve të gjurmimit me qëllim ruajtjen e gjelbërimit, ruajtjen e ambientit gjatë kryerjes së punimeve; përcaktimin/selektimin e pikës së depozitimit të hedhurinave dhe materialeve të dalta nga gjurmimi. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).
Inxhinier Gjeolog	Inxhinieri Gjeolog studion kushtet e tokës dhe shkëmbinjve për të siguruar që rruga të jetë e sigurt, e qëndrueshme dhe ekonomike. Analizon llojin e tokës dhe shkëmbinjve përgjatë gjurmës së rrugës, organizon e mbikëqyr shpimet, marrjen e mostrave dhe testimet laboratorike, Identifikon rrezikun e rrëshqitjeve të dherave ose rënies së gurëve dhe propozon masa mbrojtëse dhe kontrollon nëse kushtet reale të terrenit përputhen me projektin dhe propozon ndryshime nëse hasen probleme gjeologjike. (Referuar zërave të punimeve të preventivit).

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 3 (tre) punonjës të disponojë certifikate si "Pergjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" ne përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të deshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplome/certifikate
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mesipër dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zevendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose me të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave perkatese. Në rast perseritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontrates.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. _Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërket që operatorët ekonomikë të deshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontrates.

Kërkesa e mesipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 date 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontrates dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se

punedhenesi per mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet te ndjeke kurse formimi perkates ne fushen e sigurise e te shendetit ne vendin e punes. Cdo punedhenes zgjedh nje ose disa persona si pergjegjes per ndihme e pare ne rast emergjencash dhe per sigurine e mbrojtjen e shendetit. Rregullorja percakton kerkesat minimale te sigurise dhe te shendetit ne pune per kantieret e perkohshem ose te levizshem, si dhe masat e pergjithshme te mbikeqyrjes. Operatori/et ekonomik/e, qe gjate kryerjes se ushtrimit te veprimtarise, duhet te kete/ne kualifikimet dhe dokumentat perkatese lidhur me ndikimin ne mjedis dhe rehabilitimit te mjedisit, per raste ndotjesh sic; parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e pergjithshme per garantimin e mbrojtjes ne nje nivel te larte te mjedisit jane detyrim ligjor per cdo subjekt tregtar person fizik apo juridik per parandalimin dhe pakesimin e rreziqeve ndaj jetes e shendetit te njeriut, sigurimin dhe permiresimin e cilesise se jetes, ne dobi te brezave te sotem dhe te ardhshem, si dhe sigurimin e kushteve per zhvillimin e qendrueshem te vendit. Garantimi i ekspertizes se mbrojtjes nga cdo rrezik dhe te papritur ne pune dhe dokumentat perkatese te personave pergjegjes i sherbejne autoritetit per te krijuar bindjen dhe besueshmeri per realizimin e kontrates.

Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune rekomandohet te jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e punimeve objekt kontrate duhet te disponoje fuqi punetore prej **minimalisht 150 persona** per periudhen, 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave e vertetuar kjo me:

- Vertetim te leshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj, per periudhen 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave.

* Kriteri konsiderohet i permbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Permbledhës të Vetedeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

ARGUMENTIMI NR PUNONJESVE

Ne percaktimin e numrit te punonjesve specialisti i fushes ka bere nje analize bazuar tek faktoret, si volumet dhe kategorite e punimeve, kualifikimi i punonjesve, grafiku i punimeve, zerat e punimeve dhe oret e punes dhe pagen minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontratesn. Numri i punonjesve dhe qendrueshmeria e tyre ne pune me koheshtrirje (3 mujore nga momenti i hapjes, tregon besueshmeri per autoritetin qe, operatori do te permbushe kontraten. Deshmia e kerkuar per numrin e fuqise punetore te operatorit ekonomik e nevojshme per ekzekutimin e objektit te kontrates, eshte dokument qe verteton kapacitetin teknik dhe profesional te operatorit, persa kohe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjesve ne regjistrin e sigurimeve eshte nje detyrim ligjor i punedhenesit e parashikuar nga Kodi i Punes, per rrjedhoje vertetimi i leshuar nga administrata tatimore e shoqeruara me listpagesat me kete koheshtrirje eshte dokument vertetues per qendrueshmerine e te punesuarve, pervojen e tyre, dhe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Punesimi i nje numri te caktuar, pervec; besueshmerise se operateve ekonomik, si nje nga kerkesat themelore te kualifikimit, perpiqet te kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit ne tregun e punes. Po ashtu eshte nje tregues i kualifikimit dhe eksperiences qe duhet te kete kjo kategori e punonjesve. Vendosja e kriterit duke perfshire dhe stafin teknik, eshte ne perputhje me volumin e punes, natyren dhe

terrenin ku do te kryhen punimet. Kriteri per kualifikim eshte vendosur qe t'i sherbeje autoritetit per te njohur gjendjen e kapaciteteve te operatoreve te cilet nepermjet dokumentacionit te vertetojne se zoterojne, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshem, si dhe kapacitetet organizative, gjithcka rie funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Analizat teknike jane bazuar ne VKM nr. 216, date 13.4.2023 "Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar perinformatizimin e manualit te cmimeve per zerat e punimeve ne ndertim" Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos (material, punetori, makineri, transport) zeri fuqi punetore ze rreth 25% te kosos.

Nga llogaritja e oreve te punes per te gjithë zerat e punimeve te preventivit sipas manualit te cmimeve per fuqine puntore konkludojme si meposhte:

Total ore pune= 630,732.40 ore

Ore/1 dite pune= 8 ore

Total Dite pune punetori= 630,732.40 ore/8 ore= 78,841.55 dite pune

Dite pune gjithesej= 24 muaj (sipas grafikut te punimeve) * 22 dite/muaj= 528 dite pune

Numri I fuqise puntore = 78,841.55 dite/528 dite= 149.32 puntore afersisht 150 puntore.

Sqarim: ; Në përcaktimin e numrit të punonjësve projektuesi ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve orë e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme në pronësi/qira/kontrate furnizimi).

Nr.	Mjeti	Sasia (copë)	Statusi
1	Eskavator me zinxhire	6	në pronësi ose me qera
2	Eskavator me goma	6	në pronësi ose me qera
3	Fadrome me goma	6	në pronësi ose me qera
4	Eskavator me zinxhirë i pajisur me çekiq	3	në pronësi ose me qera
5	Minieskavatore 2 deri 9 ton	6	në pronësi ose me qera
6	Bob Cat	6	në pronësi ose me qera
7	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	6	në pronësi ose me qera
8	Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 30 ton	6	në pronësi ose me qera
9	Kamionçine me kapacitet mbajtës deri 2 ton	6	në pronësi ose me qera
10	Kamion i pajisur me vinç	3	në pronësi ose me qera
11	Nyje per prodhim inert i pajisur me leje mjedisi	2	në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
12	Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 18 ton	3	në pronësi ose me qera

13	Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 10 ton	3	në pronësi ose me qera
14	Rrul ngjeshes me vibrim deri 5 ton	3	në pronësi ose me qera
15	Grejder	2	në pronësi ose me qera
16	Autobot uji	2	në pronësi ose me qera
17	Betoniëre kantieri 500 liter	6	në pronësi ose me qera
18	Tabela sinjalistike provizore (sigurimin teknik)	60	në pronësi ose me qera
19	Zyre kantieri e levizshme (mobile)	2	në pronësi ose me qera
20	Kompresor	3	në pronësi ose me qera
21	Gjenerator	3	në pronësi ose me qera
22	Vibrator betoni	6	në pronësi ose me qera
23	Sonde shpimi UKS me kapacitet deri 30 m thellesi me diametër 0.6 m deri 1.00 m	2	në pronësi ose me qera
24	Autobetoniëre	2	në pronësi ose me qera
25	Autopomp betoni	2	në pronësi ose me qera
26	sondë shpimi për ankera	1	në pronësi ose me qera

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet të jenë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike në pronësi/qira /kontratë furnizimi, do të paraqiten këto dokumenta:

- a) Për mjetet në pronësi (që shënohen në regjistra publikë), duhet të paraqiten;- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), -plus certifikatën e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vërtetimin e pagesës për taksat vjetore.
- b) Për mjetet e siguruar me qira, duhet të paraqiten; -dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), vërtetimin e pagesës për taksat vjetore, kontrata e qirës së vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrata. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të cilave shtrihet për gjatë afatit të kontratës objekt i prokurimit janë shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e

ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper ose te kerkoje operatorit sqarime dhe dokumente mbeshtetese per keto sqarime ne perputhje me nenin 24 pika 1 te VKM nr.28 date 19.05.2021 per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.

ARGUMENTIMI MJETET

Mjetet	Proceset e punës
1. Ekskavator me zinxhir	- Germim dheu per zgjerimin e trupit te rruges, germim kasonete, germim te kanaleve te kullimit dhe germim te themeleve te mureve mbajtese e tombinove
2. Ekskavator me goma	- Germim dheu per zgjerimin e trupit te rruges, germim kasonete, germim te kanaleve te kullimit dhe germim te themeleve te mureve mbajtese e tombinove
3. Fadrome me Goma	- Shtrese çakelli t=10/15cm, makadam, perhapur e ngjeshur makineri.
4. Eskavator me zinxhirë i pajisur me çekiq	- Germim dheu per zgjerimin e trupit te rruges, germim kasonete, germim te kanaleve te kullimit dhe germim te themeleve te mureve mbajtese e tombinove
5. Miniekskavatore 2 deri ne 9 Ton	- Germim per tombinot e dimensioneve te vogla
6. BobCat	Mbushje me material kryesisht ne rruge të ngushta ku është e pamundur të shkojnë makineritë me të rënda
7. Kamione vetshkarkues mbi 20 Ton	- Transport i dherave dhe materialeve te prishjes deri ne venddepozitimin e mbetjeve te ngurta, transport i inerteve per profilimin e rruges, transport i materialeve inerte ne kantjer per mbushjen e kasonetes, mureve mbajtese e pritese, mbushjen e tombinove etj
8. Kamione vetshkarkues mbi 30 Ton	- Transport i dherave dhe materialeve te prishjes deri ne venddepozitimin e mbetjeve te ngurta, transport i inerteve per profilimin e rruges, transport i materialeve inerte ne kantjer per mbushjen e kasonetes, mureve mbajtese e pritese, mbushjen e tombinove etj.
9. Kamioncine me kapacitet deri ne 2 Ton	- Transport i tubacioneve (tubo plastmasi d=200 mm (KUB); tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm; tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm
10. Kamion i Pajisur me Vinc	- Transport dhe shkarkim i tubacioneve te betonit ne objekt (Tub metalik per tombino (me diameter dhe spesor te ndryshem sipas rastit); tuba betoni Ø 400, mbi shtrese betoni;tuba betoni Ø 500, mbi shtrese betoni; tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni; tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni;tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni; tuba betoni Ø 1500, mbi shtrese betoni

11. Nyje per prodhime inerti e pajisur me leje mjedisore	- Prodhimin e e inerteve per materialin e mbushjes per kasonete te rruges, profilimin e rruges, ndertimin e neshtresave dhe shtreses se bazes.
12. Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 18 ton	- Ngjeshjen e neshtresave dhe shtresave te cakullit
13. Rrul Gome-Cilinder me peshe mbi 10 ton	- Ngjeshjen e neshtresave dhe shtresave te cakullit, shtreses se ztabilizantit
14. Rrul ngjeshes me vibrim deri 5 ton	- Ngjeshjen e neshtresave dhe shtresave te cakullit, shtreses se ztabilizantit
15. Greider	- Mbushjen dhe nivelimin e neshtresave dhe shtresave te rruges deri tek shtresa e stabilizantit
16. Autobot Uji	- Per sperkatjen e neshtresave dhe shtresave te cakullit e shtreses se stabilizantit gjate ngjeshjes se tyre dhe njekohesisht per sperkatjen e skarpatave para torkretim
17. Betoniere kantieri 500 liter	- Per pergatitjen e betoneve te markave te uleta ne sasi te vogel ne ato vende ku nuk mund te hyje autobetoniera
18. Tabela sinjalistike provizore (sigurimin teknik)	- Per organizmin dhe mbarevajtjen e proceseve te punes, rritjen e sigurise dhe shendetit ne pune gjate ekzekutimit te punimeve.
19. Zyre kantieri e levizshme (mobile)	- Per organizmin dhe mbarevajtjen e proceseve te punes.
20. Kompresor	- Per punimet e prishjeve te betoneve
21. Gjenerator	- Per furnizimin e me energji ne rast difekti
22. Vibrator betoni	- Per vibrimin e betonit gjate betonimit
23. Sonde shpimi UKS	- Per shpimet ne toke te zakonshme e shkembore ne thellesine deri ne 30 m
24. Autobetoniere	- Per transportin ne objekt te betoneve te markave te ndryshme
25. Autopomp betoni	- Per hedhjen e betonit ne veper
26. sondë shpimi për ankera	- Per shpimin e vrimave në tokë ose shkëmb, vendosjen e shufrave ose kablllove të ankerimit dhe ben Injektimin e llaçit të çimentos për fiksimin e ankerave.

Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c; dhe 6/d, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane fuqine minimale punetore, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten.

Per te percaktuar numrin e mjeteve/makinerive te nevojshme per realizimin e kontrates, jane hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit te fushes bazuar ne VKM nr. 629, date 15.7.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, date 26.10.2018).

2.3.6 Kërkesa të tjera të vecanta për kualifikim

- Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:
- EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësive*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
 - EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
 - EN-ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Nderkombetare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH, etj., mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të leshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vertetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër; ose të kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për keto sqarime në përputhje me nenin 24 pika 1 të VKM nr.28 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është percaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësive dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Për vet natyrën e vecante, vendndodhjes dhe permasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kerkuara të cilësive. Sistemi i menaxhimit të cilësive, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qellim në arritjen e suksesit. Keto certifikata lidhen ngushtesisht me objektin e kontratës përse kohe do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësive të tyre për përmbushjen e plate të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të leshuara nga organe të pavarura, që vertetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kerkuara të cilësive, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Përpara se të shpall njoftimin e fituesit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Shënim:

Mbi mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera

Në mbështetje të nenit 84, pika 7, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 90, pika 6, të VKM nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë **nuk mund të mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera** për kriteret që lidhen drejtpërdrejtë me realizimin e proceseve kryesore të kontratës, konkretisht:

- përvojën e mëparshme të ngjashme;
- personelin/stafin kryesor;
- fuqinë punëtore minimale;
- licencat profesionale të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate.

Këto kapacitete konsiderohen thelbësore për realizimin e kontratës, pasi lidhen drejtpërdrejt me organizimin e punimeve, koordinimin e zbatimit në kantier, përputhshmërinë me specifikimet teknike dhe kërkesat ligjore, si dhe kontrollin e cilësisë dhe sigurisë gjatë realizimit të punimeve objekt kontrate. Autoriteti Kontraktor vlerëson se mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera për këto kriterë mund të cenojë realizimin efektiv dhe të besueshëm të kontratës. Për këtë arsye, këto kapacitete duhet të disponohen dhe të angazhohen drejtpërdrejtë nga operatori ekonomik ose anëtari përkatës i BOE që do të realizojë punimet, me qëllim garantimin e përgjegjshmërisë, cilësisë së ekzekutimit dhe minimizimin e riskut gjatë zbatimit të kontratës

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Projekti teknik, Specifikimet teknike, raportet teknik, preventivi me zerrat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekt projektues të licencuar dhe janë pjesë e DST.

Ne çdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante ne dokumentet e tenderit, specifikimet teknike ne kete procedure prokurimi do te pranohen edhe ekuivalent

ARGUMENTIMI I KRITEREVE PËRZGJEDHËS PËR KUALIFIKIM

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

- | | |
|---|----------|
| 1. Çmimi | pikët 70 |
| 2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë | pikët 10 |
| 3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) | pikët 10 |
| 4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) | pikët 5 |
| 5. Siguria në kantiër/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) | pikët 5 |

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi [0 - 70] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë

[0 –10 pikë]

Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këtë kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si më poshtë:

- *Punime per ndertimin e rrugeve rurale (perfshire nenshtresa rrugore, tombino, kanale, mure pritesse dhe mbajtese, guardrail, etj.) me gjatesi jo me pak se 36.3 km për kontrata të kryera gjatë pesë viteve të fundit.* [0 –8 pikë]
- *Punime per mbrojtjen e skarpatave (me rrjete teli, torkretim) me sipërfaqe jo me pak se 9,203 m² për kontrata të kryera gjatë pesë viteve të fundit.* [0 –2 pikë]

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 5 vjecar. Kriteri eshte vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punime dhe volume te kryera te realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për tu vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

P_{k2} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k2}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike te kryera)

$P_{\max k2}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e ketij kriteri do te provohet nepermjet situacioneve perfundimtare, aktit te kolaudimit sipas pikes 2.3.1 te Kapacitetit Teknik, dorezimit te detyrueshem te informacionit te permbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1) dhe cdo dokumentacion provues (sipas rastit) per volumet e kerkuara (leje ndertimi, projekti etj).

Volumet specifike për kontrata të cilat nuk janë kolauduar nuk do të përfshihen në përlllogartje. Argumentim:

“Punime per ndertimin e rrugeve rurale (perfshire nenshtresa rrugore, tombino, kanale, mure pritesse dhe mbajtese, guardrail, etj.) me gjatesi jo me pak se 36.3 km për kontrata të kryera gjatë pesë viteve të fundit

Punime per mbrojtjen e skarpatave (me rrjete teli, torkretim) me sipërfaqe jo me pak se 9,203 m² për kontrata të kryera gjatë pesë viteve të fundit.”

Përcaktimi i gjatësisë minimale prej 36.3 km për punimet e ndërtimit të rrugëve rurale dhe i sipërfaqes minimale prej 9,203 m² për punimet e mbrojtjes së skarpatave është bërë në përputhje të drejtpërdrejtë me natyrën, përmasat dhe kompleksitetin teknik të objektit të prokurimit, me qëllim garantimin që operatori ekonomik zotëron eksperiencë reale dhe të provuar në realizimin e projekteve infrastrukturore me karakter të ngjashëm.

Kërkesa për kontrata të realizuara gjatë pesë viteve të fundit është vendosur për të verifikuar kapacitetin aktual teknik dhe organizativ të operatorit ekonomik, si dhe për të siguruar që eksperiencia e paraqitur reflekton standardet bashkëkohore të realizimit të punimeve dhe volumeve specifike të kerkuara.

Shënim:

*Në mbështetje të nenit 84, pika 7, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 90, pika 6, të VKM nr. 285/2021, për këtë kriter **nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera.***

Autoriteti Kontraktor vlerëson se aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë përbëjnë aspekte kritike të kontratës dhe lidhen drejtpërdrejtë me cilësinë, organizimin teknik dhe realizimin efektiv të punimeve objekt prokurimi.

Për këtë arsye, kriteri duhet të përmbushet drejtpërdrejtë nga operatori ekonomik ofertues ose nga anëtarë përkatës i bashkimit të operatorëve ekonomikë që do të realizojë punimet përkatëse.

3. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

P_{k3} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k3}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k3}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k3} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)

[0 - 5 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- *Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:*

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

P_{k4} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k4}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k4}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k4} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: *Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.*

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)

[0 - 5 pikë]

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese oferten per vleren PSK ne rubriken specifike/zerin “Siguria ne kantier (Plani I Sigurise e Kordinimit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, date 13.04.2023)”, ne preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur ne mënyrë të posacme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë

punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatëse të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të vecantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e vecantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”* (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike në masën jo më pak se 3%, përlllogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas përcaktimeve të VKM nr. 216 datë 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast **jo më pak se 37,500,000.00 leke pa tvsh**. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Përmbajtja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zërin Siguria në kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollin të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. **“LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”**

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht 37,500,000.00 leke pa tvsh.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 37,500,000.00 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 37,500,000.00 leke pa tvsh, do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria ne kantier/shendetit, impakti ne mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendetit, impakti ne mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendetit, impakti ne mjedis dhe social” **nëse vlera e saj do të jetë më shume se dyfishi i** mesatares së ofertave të vlefshme.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendetit impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O – (pikët e Ofertës)

Mo – Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme

N – Numri i ofertave të vlefshme

PR (Rm) – Rritje e mundshme

Mo = $O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n / N$

PR = 200 % Mo

Vlera e ofertave të ofruara > PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendetit impakti ne mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK (200% MO = 51,500,000 leke < 55,000,000 leke) dhe vlerësohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i

punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlera korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.